



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.07.2024

Nr: 124

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOALICIONIT BASHKË FITOJMË PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 25.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2135 Prot., datë 24.07.2024, me:

Kërkues: Partia politike “Partia Demokratike”, drejtuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, e përfaqësuar nga z. Sali Berisha.

Objekti: Regjistrimi i koalicionit “BASHKË FITOJMË” (BF), për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Baza ligjore: Neni 65 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të

Data: 25.07.2024 Nr: 124
Ora: 11:30



“Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “BASHKË FITOJMË” (BF), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

zhvillohen më datë 4 gusht 2024”, ka caktuar datën 24.7.2024 si afatin e fundit për paraqitjen e kërkesës në KQZ, për regjistrimin si koalicion për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë.

“Partia Demokratike”, e perfaqësuar nga z. Sali Berisha, brenda afatit të ligjor përcaktuar ka paraqitur kërkesën me nr. 2135 prot., datë 24.07.2024 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” është depozituar marrëveshja e nënshkruar nga kryetarët e partive politike pjesëmarrëse në koalicion, të cilat do të jenë: 1. “Partia Demokratike”, 2. “Partia e Lirisë”, 3. “Partia Demokratiane e Shqipërisë”, 4. “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, 5. Partia “Fryma e Re Demokratike”, 6. “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, 7. Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, 8. “Partia Balli Kombëtar”, 9. “Partia Republikane Shqiptare”, 10. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”.

Marrëveshja e sipërcituar përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të 10 (dhjetë) partive pjesëmarrëse për të qenë pjesë e koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “BASHKË FITOJMË”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “BF”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Sali Berisha, kryetar i partisë “Partia Demokratike”/ose të autorizuarin prej tij, të paraqesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe/ose KZAZ, kandidatin për kryetar bashkie në këtë njësi;
6. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Partia Demokratike”;
7. Autorizimin e z. Flamur Noka, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
8. Autorizimin e z. Flamur Noka, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
9. Autorizimin e z. Flamur Noka, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ, si dhe cdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, deri në përfundim të procesit zgjedhor;

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor:

1. Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.
2. Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ketë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e koalicionit.
3. Kushti i tretë është që numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion duhet të jetë dy ose më shumë se dy.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se, kërkesa për t'u regjistruar si koalicion, është e bazuar për partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. “Partia Demokratike”, drejtuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, e përfaqësuar nga z. Sali Berisha, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 112 datë 23.07.2024.
2. “Partia e Lirisë”, me kryetar z. Ilir Metaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 114 datë 23.07.2024.
3. “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, me kryetar z. Nard Ndoka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 116 datë 23.07.2024
4. “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar z. Vangjel Dule, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 119 datë 23.07.2024
5. Partia “Fryma e Re Demokratike”, me kryetar z. Sali Shehu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 115 datë 23.07.2024
6. “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 113 datë 23.07.2024
7. Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, me kryetar z. Artur Roshi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 117 datë 23.07.2024
8. “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar z. Adriatik Alimadhi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 120 datë 23.07.2024
9. “Partia Republikane Shqiptare”, me kryetar z. Fatmir Mediu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 111 datë 23.07.2024
10. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, me kryetar z. Agron Duka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 118 datë 23.07.2024

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenet 64, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Regjistrimin e Koalicionit “BASHKË FITOJMË”, përfaqësuar nga z. Sali Berisha, me shkronja nistore “BF”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, e përbërë nga subjektet zgjedhore si më poshtë:
 - a) “Partia Demokratike” (PD);
 - b) “Partia e Lirisë” (PL);
 - c) “Partia Demokristiane e Shqipërisë” (PDK);
 - d) “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ);
 - e) Partia “Fryma e Re Demokratike” (FRD);

- f) “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” (PBD);
 - g) Partia “Balli Kombëtar Demokrat” (PBKD);
 - h) “Partia Balli Kombëtar” (PBK);
 - i) “Partia Republikane Shqiptare” (PR);
 - j) “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” (PAA).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI